

VENDIM
“Për sekuestro preventive të pasurive”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

MANJOLA BEJLERI - Gjyqtare

Asistuar nga sekretare **Eliana Sharra**, sot me **dt.05.06.2015** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale me Nr..... Akti, që i përket:

KËRKUES: **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e përfaqësuar nga Prokurore **Antoneta Sevdari**.

OBJEKTI: Sekuestro preventive e pasurive.

BAZA LIGJORE: Neni 274 i K.Pr.Penale dhe neni 36 i K.Penal.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata pasi shqyrtoi aktet, bisedoi çështjen, administroi provat dhe mori pretendimin e fundit të prokurores e cila kërkoi pranimin e kërkesës,

VËREN:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur, bazuar në nenin 274 të K.Pr.Penale dhe 36 të K.Penal, kërkesën për lejimin e sekuestros preventive të pasurive (sendeve) që shtetasit nën hetim L C., M. D. R. dhe E. T. zotërojnë në raport me kuotat e tyre në Shoqërinë “E.....” sh.p.k, Shoqërinë “C...S...” shpk, Shoqërinë “4...” sh.p.k, Shoqërinë “F.....” sh.p.k dhe Shoqërinë “A.....” shpk, deri në shumat 39.001.863 euro dhe 770,423,159 lekë, që Shoqëria “E.....” shpk ka përfituar dhe transferuar tek Shoqëria “C... S...” shpk, Shoqëria “4...” shpk, Shoqëria “F.....” shpk dhe Shoqëria “A.....” shpk, , lidhur me procedimin penal Nr....., të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Nga aktet e hetimit paraprak rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr....., të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Ky procedim penal është rregjistruar mbi bazën e materialeve të dërguara nga Drejtoria e

Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat rezulton se ndërmjet shoqërive “K... G... E...” sh.p.k.; “C... S...” sh.p.k.; “4...” sh.p.k.; “E.....” sh.p.k.; “F.....” sh.p.k.; “I.....” sh.p.k. dhe “A.....” sh.p.k., janë kryer transaksione financiare të dyshimta dhe pa llogjikë ekonomike. Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë rezulton se në drejtim të Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k sh.p.k. janë transferuar para nga jashtë vendit, për të cilat ka dyshime se burimi i tyre vjen nga veprimtari të paligjshme kriminale.

Për të verifikuar burimin e parave të transferuara në llogaritë e Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k sh.p.k, si dhe për të vërtetuar nëse ortakët e kësaj shoqërie janë përfshirë në veprimtari kriminale, është dërguar letërporosi në disa shtete, përgjigja e të cilave nuk ka ardhur akoma.

Hetimet në këtë procedim penal janë kryer edhe në drejtim të aktivitetit ekonomik të kryer në Shqipëri nga Shoqëritë “K... G... E...” sh.p.k sh.p.k dhe “E.....” sh.p.k, për shkak se gjatë hetimit të procedimit penal si dhe bazuar në referimin e dërguar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, janë krijuar dyshime se përfaqësues të Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk, në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë “E.....” shpk, kanë zmadhuar vlerën e investimit të kryer realisht në H..... Nga hetimi ka rezultuar se përfaqësuesi kryesor i shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk, nga momenti i krijimit deri në muajin Tetor të vitit 2013, ka qenë shtetasi F. B., i cili rezulton të jetë ortak i kësaj shoqërie në masën 20%. Shoqëria shqiptare “E.....” sh.p.k. ka si përfaqësues ligjor shtetasin M. D. R., i cili zotëron 20% të kuotave dhe Shoqërinë Italiane “C.....” shpk me 80% të kuotave, ku tek kjo e fundit pronare kryesore (ortakia që zotëron shumicën e kuotave prej 99.5%) është shtetasja L. C., e cila rezulton të jetë edhe nëna e shtetasit nën hetim F. B.. Gjithashtu L. C. rezulton të ketë qenë deri në muajin Tetor të vitit 2013, një nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk.

Nga hetimet e kryera në këtë procedim penal kanë rezultuar të dhëna se shtetasit nën hetim M. D. R. dhe F.B. dyshohet të kenë kryer veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë”, “Mospagimin e taksave dhe tatimeve”, dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 186/2, 181 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga hetimet praraprake është arritur të provohohen këto fakte:

-Shoqëria “E.....” sh.p.k ka faturuar në shumë raste për Shoqërinë “K... G... E...” sh.p.k shpk punime të pakryera, duke falsifikuar situacionet e punimeve;

-Shoqëria “E.....” shpk për ndërtimin e h.....ka blerë punime nga nënkontraktorët e saj dhe më pas, këto punime ia ka shitur

Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk, duke rritur disa herë vlerën e punimeve të blera nga nënkontraktorët;

-Si rrjedhojë e pikës së parë dhe të dytë Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk ka rritur në mënyrë fiktive kreditimin e TVSH-së;

-Shoqëria “E.....” sh.p.k nuk ka paguar detyrimet tatimore në shumën mbi 770,423,159 Lekë edhe pas marjes së masave administrative të vendosura nga Drejtoria Rajonale e Tatim Paguesve të Mëdhenj, megjithë mundësitë që ka pasur për likuidimin e detyrimeve;

-Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore ka bërë likuidimin e faturave të shoqërisë “E.....” shpk nëpërmjet Shoqërisë “C... s...” sh.p.k, e cila ashtu si Shoqëria “E.....”, zotërohet në masën 80% nga Shoqëria “C.....” shpk me 80% të kuotave, ku ortakia që zotëron shumicën e kuotave prej 99.5% është shtetasja L. C..

-Nga hetimi ka rezultuar se në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, përfaqësues të “... Bank” sha, kanë lejuar kryerjen e transaksioneve bankare në llogaritë e Shoqërisë “E.....” në kundërshtim me Urdhërin e Bllokimit Nr..... Prot., dt.17.08.2012 të vendosur nga Drejtoria Rajonale e Tatim Paguesve të Mëdhenj, duke lejuar qarkullim e miliona eurove në llogaritë e kësaj shoqërie;

-Përfaqësuesit ligjorë të dy shoqërive, në mënyrë fiktive, kanë sajuar një mosmarrëveshje me objekt “shpërbllim dëmi”, për zgjidhjen e së cilës i janë drejtuar Gjykatës së në Shqipëri, Qendrës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “M.....”. Në këtë gjykim palët kanë paraqitur dokumenta të falsifikura, kryesisht situacione me të dhëna të pavërteta, për punime të pakryera realisht. Në përfundim të gjykimit, gjykata bazuar në dokumenta të falsifikuara ka vendosur të “**zgjidhë**” mosmarrëveshjen, duke pranuar padinë e Shoqërisë “E.....” shpk dhe duke vendosur detyrimin e Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk të paguajë në favor të Shoqërisë “E.....” shpk shumën prej 48.051.606 Euro. Në bazë të vendimit të Gjykatës rezulton se Shoqëria “E.....” shpk ka pësuar dëm, për shkak se Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk nuk e ka paguar për 911 ditë për disa punime të kryera prej saj në vitin 2009 (kryesisht zëri i punimeve të pakryera është “*përgatitja e materialit të selektuar dhe të shoshuar për ngritjen e trupit të digës*”). Siç do të analizohet më poshtë, ky proces pune nuk është kryer fare;

-Pas zbardhjes së vendimit të Gjykatës Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk, ka kaluar në favor të Shoqërisë “E.....” shpk në bankat shqiptare miliona Euro (mbi 15.000.000 Euro), por edhe në llogari të tjera të kësaj shoqërie në shtetin e Luksemburgut, para të cilat më pas, janë përfshirë në aktivitetin ekonomik. Kryesisht këto para kanë shkuar për financim ortaku “C... s...” shpk dhe “4...” shpk, të cilat janë shoqëri pa aktivitet ekonomik.

Në referim të kronologjisë se si kanë rrjedhur ngjarjet, faktet penale që i atribuohen shtetasve nën hetim rezulton se kanë ndodhur në rrethanat si më poshtë.

Me Vendimin Nr....., datë1997 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Marrëveshjen për me Shoqërinë Italiane “B...” S.p.a. Kjo marrëveshje është ndryshuar me Vendimet Nr....., datë2000 si dhe Nr....., datë2007 të Këshillit të Ministrave.

Në vendimin e fundit të KM u miratuan ndryshime të reja në Kontratën për ndërtimin e, duke u legjitimuar pjesëmarrja e një partneri të ri në konçesion dhe pikërisht operatorit ekonomik “D... B...”. Kapitali fillestar i shoqërisë konçensionare sipas marrëveshjes duhet të ishte 15.000.000 Euro. Për këtë arsye, në vitin 2007 Konçesionari “B.....” S.p.a. krijon në Itali Shoqërinë “H.....” Srl, në të cilën “B.....” S.p.a. zotëronte 55% të aksioneve dhe “D... B...” 45% të aksioneve (sot “B.....” S.p.a. zotëron 100% të kuotave). Gjithashtu, në të njëjtën kohë në Shqipëri u krijua Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k sh.p.k. me ortak të vetëm Shoqërinë “B.....” S.p.a. Qëllimi i krijimit të shoqërisë ishte kryerja e punimeve në , si nënkontraktore e shoqërisë konçensionare.

Bazuar në kontratën e lidhur me shtetin Shqiptar shoqëria konçensionare ka qënë e detyruar që për ndërtimin e të lidhë një kontratë me një shoqëri me eksperiencë për ndërtimin e Shoqëria konçensionare ka lidhur kontratën me shoqërinë “G... c...” për ndërtimin e, por kjo kontratë nuk hyri në fuqi për shkak se shoqëria konçensionare nuk bëri të mundur sigurimin e kontratës konçensionare nga Shoqëria italiane “S.....”, kusht pa të cilin Shoqëria ”G... C...” nuk mund të vazhdonte punimet. Në pritje të lidhjes së kontratës me shoqërinë zbatuese, fillimisht Shoqëria “A... B...” dhe më pas Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk, lidhën një kontratë me Shoqërinë shqiptare “E.....” shpk për kryerjen e disa punimeve që mund të konsiderohen përgatitore. Vlen të theksohet se shoqëria “E.....” shpk është shoqëri e lidhur me grupin “B.....” S.p.a. Siç u shpjegua më sipër kjo shoqëri zotërohet në masën 80% nga Shoqëria Italiane “C.....” dhe kjo e fundit zotërohet në masën 99.5 % nga shtetasja L. C., e cila është nëna e shtetasit italian F. B.. Ky i fundit ka nënshkruar kontratën konçensionare dhe ka qënë deri në muajin Tetor të vitit 2013, Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “K.....” shpk, madje “*de fakto*” është sjellë si administrator dhe pronar i të gjitha shoqërive të sipërcituara.

Nga hetimi ka rezultuar se Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë viteve 2012 dhe 2013 ka ushtruar kontroll mbi zbatimin e marrëveshjes së konçensionit të sipërcituar dhe nga kontrollet e ushtruara, ka rezultuar se gjatë zbatimit të punimeve ka mungesa të theksuara dokumentacioni, nuk ka projekt

të nënshkruar, si dhe raporte supervizimi të kryerjes së punimeve. Gjithashtu, dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë konstatuar një sërë parregullsish në punimet dhe dokumentacionin e mbajtur nga shoqëria si dhe rezultojnë vonesa pa fund të kryerjes së punimeve.

Dyshimet e para në lidhje me fryrjen fiktive të punimeve kanë rezultuar nga Akti i Kontrollit i kryer nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj i vitit 2014, nga i cili ka rezultuar se vlera e punimeve të shitura Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk nga Shoqëria “E.....” shpk është disa herë më e lartë (deri 23 herë) se vlera e punimeve që kjo shoqëri (Shoqëria “E.....” shpk), ka blerë nga nënkontraktorët e saj.

Për të verifikuar këtë dyshim të ngritur gjatë hetimit të çështjes penale, u vendos kryerja e një akti ekspertimi kontabël, me qëllim që të bëhej krahasimi i volumeve të punimeve të blera nga Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk nga kontraktori i vetëm “E.....” shpk, me volumet e blera nga kjo e fundit nga nënkontraktorët e saj. Krahasimi u kërkuar të bëhej jo vetëm në vlerën e punimeve, por edhe në llojin dhe sasinë e punimeve. Punimet në ndërtimin, Shoqëria “E.....” shpk i ka bërë me shoqëri të treta nënkontraktore.

Nga Akti i Ekspertimit kontabël është arritur në konkluzionin se: **Shoqëria ”E.....” shpk rezulton se ka rritur cmimet e punimeve në shitje shumë-herë nga cmimet e blerjes, dhe ka shitur volume punimesh në sasi më të madhe se sa volumet e punimeve të blera. Gjithashtu, rezulton që shoqëria të ketë shitur edhe punime të cilat nuk i ka blerë fare.**

Më poshtë paraqiten të dhënat e rezultuara nga akti i ekspertimit kontabël, i ndarë sipas viteve të kryerjes së punimeve në nga Shoqëria “K.....” shpk.

Viti 2007

Për vitin 2007 kjo shoqëri ka blerë situacione punimesh gjithsej në shumën prej 1,035,295 euro, nga:

- Shoqëria “S.....” shpk në shumën 350.000 euro, me situacion përkatës gërmime, në volume 54,047m³.
- Shoqëria “A....” shpk në shumën 125.000 euro, me situacion përkatës gërmime, në volume 25,510m³.
- Shoqëria “Sh.....” shpk në shumën 560.000 euro me dy fatura. Njera faturë në vlerën 200.000 euro me përshkrim punime Ura..... pa situacion. Fatura tjetër nuk ka situacion, por me përshkrim për devijimin e lumit në Urë, në volume 240,000 m³, në vlerë 360,000 euro.

Per vitin 2007 kjo shoqëri i ka shitur situacione investitorit “K... G... E...” sh.p.k shpk gjithsej në vlerën 5,743,455 euro me zërat kryesorë të punimeve:

-Shitje punime gjurmimi shkarkuesi sipërfaqësor në volume 294,580 m³ dhe vlerë 2,998,024 euro.

-Shitje punime ndërtimi i Urës, kryesisht punime gjurmimi në volume 360,400 m³ dhe punime të tjera gjithsej në vlerën 2,745,431 euro.

Për sa më sipër konstatojmë se nga aktiviteti i Shoqërisë "E...." shpk rezulton se:

-Janë blerë punime gjurmimi për veprën ndërtimi i shkarkuesit sipërfaqësor në volume **79,557 m³** dhe ka shitur (situacionuar) investitorit "K... G... E..." sh.p.k shpk volume **294,580 m³**, me një diferencë në volumë të shitura më shumë prej **215,023 m³**.

-Janë blerë punime gjurmimi për ndërtimin e Urës në volume 240,000 m³ dhe ka shitur (situacionuar) investitorit "K... G... E..." sh.p.k shpk në volume 329,400 m³, me një diferencë në volume prej **89,400 m³**.

Shoqëria përveçse ka rritur çmimet e punimeve në shitje shumë-herë mbi çmimet e blerjes, konstatohet se ka shitur volume punimesh në sasi më shumë se sa volumet e punimeve të blera. Kjo diferencë volumesh e trajtuar më sipër rezulton e paargumentuar me dokumentacion.

Viti 2008

Per vitin 2008 kjo shoqëri ka blerë situacione punimesh gjithsej 8,099,616 euro, nga:

- Shoqëria "A....." shpk - 3,284,003 euro me situacion përkatës, kryesisht gjurmime në volume 662,045 m³ dhe në vlerë 3,217,918 euro.

- Shoqëria "C....." shpk - 3,743,842 euro me situacion përkatës, kryesisht gjurmime në volume 805,271 m³ dhe në vlerë 3,677,722 euro.

- Shoqëria "S....." shpk - 639,642 euro me dy fatura pa situacione punimesh dhe një kontratë në gjuhën Italiane.

- Shoqëria "Sh....." shpk 315,425 euro me situacion përkatës në gjuhën italiane, kryesisht punime Ura në vlerën 132,534 euro dhe punime Vila, Impianti i Betonit, Ujësjiellësi, si dhe bërje blloqe betoni.

- Shoqëria "N....." shpk - 116,000 euro me situacion përkatës, kryesisht ngarkim dhe transport materiali në volume 106,094 m³.

Për vitin 2008 kjo shoqëri ka shitur situacione investitorit "K... G... E..." sh.p.k shpk gjithsej në vlerën 14,820,797 euro me zërat kryesorë të punimeve:

-Shitje punime gjurmimi shkarkuesi sipërfaqësor në volume 1,560,570 m³ dhe vlerë 14,432,249 euro, si dhe furnizim vendosje blloqe betoni 1,900 m² në vlerë 388,550 euro.

Për sa më sipër konstatojmë se nga aktiviteti i Shoqërisë "E...." shpk rezulton se:

-Janë blerë punime gjurmimi për veprën Ndërtimi i shkarkuesit sipërfaqësor në volume 1,573,410 m³ dhe ka shitur (situacionuar) investitorit “K... G... E...” sh.p.k shpk 1,560,570 m³, me një diferencë në volume të blera më shumë **93,254 m³**.

Diferenca është në shumën 93,254 m³ dhe cmimi i shitjes së volumeve është afërsisht 2-herë më i lartë nga cmimi i blerjes.

Viti 2009

Për vitin 2009 kjo shoqëri ka blerë situacione punimesh gjithsej 146,598 euro, nga:

- Shoqëria “C.....” shpk - 64,941 euro me situacion përkatës, kryesisht gjurmime në volume 12,146 m³.

- Shoqëria “N.....” shpk, Shoqëria “B.....” shpk dhe Shoqëria “F.....” shpk, kryesisht gjurmim, ngarkim dhe transport materiali afërsisht 27,778 m³ në vlerë 81,657 euro.

Për vitin 2009 kjo shoqëri ka shitur situacione investitorit “K... G... E...” sh.p.k shpk gjithsej në vlerën 1,651,097 euro me zërat kryesorë të punimeve:

-Shitje punime gjurmimi shkarkuesi sipërfaqësor dhe diga në volume 251,958 m³ dhe vlerë 1,188,617 euro, si dhe punime të tjera për diferencë 462,480 euro.

Për sa më sipër konstatohet se nga aktiviteti i Shoqërisë “E.....” shpk rezulton se:

-Janë blerë punime gjurmimi për veprën ndërtimi i shkarkuesit sipërfaqësor në volume 39,924 m³ dhe ka shitur (situacionuar) investitorit “K... G... E...” sh.p.k shpk 251,958 m³, me një diferencë në volume të shitura më shumë **212,034 m³**.

Shoqëria përveçse ka rritur cmimet e punimeve në shitje shumë-herë nga çmimet e blerjes, konstatohet se ka shitur volume punimesh në sasi më shumë se sa volumet e punimeve të blera. Kjo diferencë volumesh e trajtuar më sipër rezulton e paargumentuar me dokumentacion.

Këto punime janë shitur në muajin Shkurt 2009 (sipas Faturës Nr....., datë 15.02.2009), pavarësisht se nuk ka asnjë blerje nga nënkontraktorët deri me atë datë). Ndërsa blerjet prej 146,598 euro janë blerje nga nënkontraktorët pas muajit Shkurt 2009 deri në Dhjetor 2009.

Megjithatë në vitin 2009 ka diferencë akoma më të mëdha nëse do të pranojmë faktin që janë edhe disa situacione të tjera të paraqitura në gjykatën e, për të cilat shoqëria pretendon se i ka kryer në vitin 2009.

Konkretisht, sipas këtyre situacioneve të paraqitura në ..., punimet e kryera gjatë vitit 2009 janë gjithsej për shumën 5,112,939 euro (situacione të hartuara të periudhave Shkurt-Tetor 2009).

Volumet e këtyre situacioneve të paraqitura në janë të konsiderueshme, kryesisht **”përgatitje në këmbët e veprës e materialit të seleksionuar dhe të shoshuar për ngritjen e trupit të digës 1,705,470m3, në vlerë 3,410,940 euro**, gërmime 111,089 m3 në vlerë 899,640 euro, Kavo me fibra optik në themel, asetimetri hidraulik në kuotë 75.5m për matje, stacioni meteorologjik dhe hidrometrik 300,000 euro, si dhe Ujësjellësi Fshati..... 330,000 euro.

Shoqëria ”E.....” shpk gjatë vitit 2009 ka paraqitur 2 situacione punimesh në muajin Shkurt 2009: njerin të deklaruar me Faturën Nr....., datë 15.02.2009 dhe tjetrin e ka deklaruar me Faturën Nr....., datë 29.10.2010 (paraqitur në). Gjithashtu, theksohet se janë deklaruar punime të kryera në muajin Prill 2009 në vlerën 505.000 euro (shoshim materiali deklaruar me Faturën Nr....., datë 29.10.2010) dhe në muajin Maj 2009 në vlerën 330.902 euro (ndërtim ujësjellësi Fshati).

Të gjitha këto punime të deklaruara si të kryera në periudhën Shkurt 2009 deri Prill 2009, nuk vërtetohen me dokumentacion se kush i ka kryer, pasi shoqëria gjatë kësaj periudhe ka blerje punimesh vetëm nga “C.....E” shpk në vlerën 64.941 euro (ku gërmime janë 5.108 m3 të situacionuara në muajin Shkurt 2009) dhe nuk ka blerje të tjera punimesh nga nënkontraktorë.

Punimet e situacionuara gjatë kësaj periudhe (korrik, gusht dhe tetor 2009) janë deklaruar me Faturat Nr....., datë 28.03.2011 dhe Nr....., datë 06.12.2011). Nuk ka asnjë dokumentacion të shoqërisë ku të vërtetojë kryerjen e punimeve nga ana e saj. Për këto punime të pashoqëruara me dokumentacion shoqëria ka kërkuar rimbursim të TVSH-së për vlerën **45,393,878 lekë**.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se procesi i punës: **”Përgatitje në këmbët e veprës e materialit të seleksionuar dhe të shoshuar për ngritjen e trupit të digës” 1,705,470 m3 në vlerën 3,410,940 euro, nuk është kryer fare si proces, përmendim këtu deklarinimet e shtetasve E. C., S. P., S. B., A. X. etj.**

Viti 2010

Për vitin 2010 kjo shoqëri nuk ka blerë situacione punimesh nga asnjë shoqëri tjetër.

Për vitin 2010 kjo shoqëri ka shitur situacione investitorit “K... G... E...” sh.p.k shpk gjithsej në vlerën 1,841,000 euro me zë punimi:

-Shitje punime përgatitje në këmbët e veprës e materialit të seleksionuar dhe të shoshuar për ngritjen e trupit të digës në volume 920,500 m3 në vlerën 1,841,000 euro.

Per vitin 2011

Shoqëria "K... G... E..." sh.p.k shpk ka blerë situacione punimesh vetëm nga Shoqëria "E... Q..." shpk në vlerën totale 284.000 euro, kryesisht punime gërmimi 41.812 m³.

Për vitin 2011 "E....." shpk nuk ka deklaruar në shitje situacionet e blera nga subjekti "E... Q..." shpk, por ka deklaruar në shitje investitorit "K.....shpk vlerën **1,621,842 euro** punime, që sipas situacioneve me data të paraqitura në janë në muajt **Maj, Korrik, Gusht dhe Tetor 2009**.

Në mënyrë të përmbledhur këto situacione përmbajnë "Përgatitje në këmbët e veprës e materialit të seleksionuar dhe të shoshuar për ngritjen e " në volume 644,970 m³, në vlerë 1,289,940 euro dhe ndërtimi i pa situacion, me zëra punimesh në shumën 330,000 euro (copë 1).

Për Vitin 2012

Për vitin 2012 kjo shoqëri ka deklaruar blerje situacione punimesh nga shoqëria "E... Q..." shpk në shumën 264,405 euro, kryesisht punime gërmimi me matrapik në volum 30.781m³. Për vitin 2012 kjo shoqëri ka shitur me fatura tatimore gjithsej punime në vlerën 4,479,613 euro, ndërsa me situacione punimesh për investitorin "K... G... E..." sh.p.k shpk gjithsej në vlerën 3,200,540 euro.

Diferenca prej 1,279,073 euro, përbën shitje punimesh të paargumentuara.

Shoqëria "E....." shpk ka deklaruar në shitje punime ndërtim zyresh 946,586 euro, ku nuk ka blerje situacione për ndërtimin e zyrave. Gjithashtu, ka shitur në vlerën 1,682,324 euro vetëm me fatura tatimore, pa situacione punimesh. Nga hetimi ka rezultuar se punimet për ndërtimin e zyrave kanë përfunduar deri në nivelin e karabinasë në vitin 2009. Për ndërtimin e këtyre zyrave nuk ka fare projekt dhe situacioni për këto punime është i falsifikuar.

Shoqëria përveçse ka rritur cmimet e punimeve në shitje shumë herë më tepër nga çmimet e blerjes, konstatohet se ka shitur volume punimesh në sasi më shumë se sa volumet e punimeve të blera. Kjo diferencë volumesh e trajtuar më sipër, rezulton e paargumentuar me dokumentacion.

Viti 2013

Për vitin 2013 kjo shoqëri ka deklaruar blerje situacione punimesh gjithsej në vlerën 454,905 euro si më poshtë:

-Blerje nga "E....." shpk në vlerën 146,085 euro punime, ndërtim i zyrave dhe strehim, me situacion të pafirmosur nga subjekti "E....." shpk.

-Blerje nga "Sh....." shpk punime gërmimi në volume 10,800 m³, për vlerën 83,333 euro dhe punime ndërtim impianti të betonit 133,168 euro.

-Blerje nga "E... Q..." shpk punime, mbyllje kontrate në vlerën 62,985 euro, pa situacion punimesh.

-Punime shpim me pilota në volume 178 ml në vlerë të tatueshme 33,334 euro.

Për vitin 2013

Shoqëria "E....." shpk ka lëshuar fatura tatimore me përshkrimin "Punime ne gjithsej 4,711,643 euro, ndërsa vlera e punimeve me situacione për investitorin "K... G... E..." sh.p.k shpk, është gjithsej në vlerën 1,593,871 euro me zë punimi si më poshtë:

-Shitje punime ndërtim zyra dhe strehim në vleren 300,000 euro, pa situacion përkatës.

-Shitje Ura e Betonit në vlerën 364,703 euro, vetëm me një situacion të përpiluar në fund të vitit 31.12.2013 dhe në gjuhën Italisht.

-Shitje Stabilizim Skarpatash në vlerën 304,841 euro, vetëm me një situacion të përpiluar në fund të vitit 31.12.2013 dhe në gjuhën Italisht.

-Shitje galeria e devijimit në vlerën 512,626 euro, vetëm me një situacion të përpiluar në fund të vitit 31.12.2013 dhe në gjuhën Italisht.

-Shitje galeria e inspektimit në vlerën 111,701 euro, vetëm me një situacion të përpiluar në fund të vitit 31.12.2013 dhe në gjuhën Italisht.

Për sa më sipër konstatohet se nga aktiviteti i Shoqërisë "E....." shpk rezulton se Shoqëria përveçse ka rritur cmimet e punimeve në shitje shumë herë nga cmimet e blerjes, konstatohet se ka shitur volume punimesh në sasi më të madhe se sa volumet e punimeve të blera. Kjo diferencë volumesh e trajtuar më sipër rezulton e paargumentuar me dokumentacion. Si rrjedhojë, këto situacione janë fiktive, pra të falsifikuara për shkak se në këto situacione nuk pasqyrohen rrethana të vërteta.

Gjatë hetimit të çështjes është kryer edhe një akt ekspertimi teknik nga inxhinjerë dhe ekonomistë të AKBN, nga i cili ka rezultuar se punimet faktike të kryera në janë më të vogla se punimet e raportura.

MOSPAGIMI I DETYRIMEVE TATIMORE NGA SHOQËRIA "E....." SH.P.K.

Shoqëria "E....." Sh.p.k me NIPT K.....P, me Administrator Z.M. D. R. rezulton se ka detyrime tatimore (borxh) deri me dt.30.12.2014 në shumën prej **770,423,159 lekë (përveç detyrimeve të tjera që janë në proces apelimi).**

Ndaj subjektit janë marrë masa administrative dhe Shoqëria "E....." sh.p.k. nuk i ka paguar taksat dhe tatimet megjithë mundësinë që ka pasur për shlyerjen e detytimeve.

Nga transaksionet bankare rezulton se pas lëshimit të Urdhërit të Bllokimit Nr..... Prot., dt.17.08.2012 nga Drejtoria Rajonale e Tatim Paguesve të Mëdhenj, në llogaritë e shoqërisë kanë kaluar Miliona Euro dhe detyrimet tatimore nuk janë paguar.

Transaksionet financiare janë kryer në Bankën "....." sh.a., e cila edhe pse ka marrë dhe ka rregjistruar në sistem urdhër bllokimin, ka kryer

transaksionet në kundërshtim me urdhërin e lëshuar nga tatimet, duke i shkaktuar një dëm të konsiderueshëm buxhetit të shtetit.

Gjithashtu për shmangien e detyrimeve tatimore nga Shoqëria “E.....” shpk, Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk ka kryer pagesat në llogaritë e Shoqërisë “C... s...”. Pagesat janë kryer me përshkrimin “Pagesë për Shoqërinë “C... s...” në favor të Shoqërisë “E.....” shpk për likuidim fature.

Nga hetimi ka rezultuar se gjykimi në është zhvilluar për një mosmarrëveshje fiktive (të pavërtetë) dhe është bazuar në dokumenta të falsifikuara të krijuara me marrëveshje midis dy shoqërive “K... G... E...” sh.p.k shpk dhe “E.....” shpk.

Për të vërtetuar vonesat në fillimin e punimeve Shoqëria “E....” shpk ka paraqitur korespondencën e saj me Shoqërinë “K... G... E...” sh.p.k, korespondencë e cila fiktivisht fillon të kryhet me Shoqërinë “K.....” shpk, me përfaqësues Z. F. B. nga data 11.06.2007 (shtojca 3, shtojca 4, shtojca 5, shtojca 6, shtojca 7 e paditësit) e në vazhdim. Kjo korrespondencë është fiktive. Kështu në dokumentat e paraqituara në gjendet Shkresa e datës 11 Qershor 2007, në bazë të së cilës Shoqëria “E.....” shpk i drejtohet Shoqërisë “K... G... E...” sh.p.k shpk, me qëllim që të caktohet data kur do të dorëzohet kantieri. Në 19 Qershor 2007, tashmë Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k i drejtohet Shoqërisë “E...” shpk dhe i bën me dije se nuk mund ta dorëzojë kantierin për shkaqe administrative, por i kërkonte të ruante administrimin, për dorëzim tashmë të afërt të punimeve. Vazhdojnë Shkresa në datën 27.06.2007 dhe 29.06.2007 prapë ndërmjet këtyre dy shoqërive. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk është krijuar sipas statutit të saj me datë 09.07.2007, por e rregjistruar në QKR me datë2007 .

Si përfundim në këtë çështje theksohet se Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk nuk ka ekzistuar para datës 09.07.2007 dhe si rrjedhojë, Shoqëria “E...” shpk nuk mund të ketë korrespondencë shkresash apo punime të kryera me një shoqëri që nuk ekziston.

Punimet të cilat pretendohen se nuk është kryer pagesa, e cila ka sjellë si pasojë “*mosvazhdimin e punimeve*”, në fakt nuk janë kryer fare.

Inxhinierët të cilët kanë qenë prezent në kantier kanë deklaruar se në vitin 2009 nuk është kryer procesi i “Përgatitjes së materialit të seleksionuar dhe të shoshuar në trupin e digës (S. P., Ë. C., I. I., A. X., etj).

Nuk rezulton që Shoqëria “E.” shpk të ketë blerë punime të këtij lloji nga nënkontraktorët e saj, që më pas të kishte mundësi t’i shiste.

Situacionet e punimeve fotokopje të cilat janë paraqitur në AKBN, apo pranë tatimeve rezulton të jenë të firmosura nga mbikqyrësi i punimeve E. C., ndërkohë që ky i fundit deklaroi se nuk ka qenë përpara vitit 2011 mbikqyrës i punimeve, por vehtëm inxhinier i Shoqërisë “E.....” shpk.

Në muajin maj të vitit 2009 shoqëria ka prerë një faturë me përshkrimin “paradhënie” për punimet në (Sqarojmë se faturat paradhënie lëshohen për punime që do të kryhen apo janë duke u kryer, por që nuk janë marrë akoma në dorëzim). Kjo faturë paradhënie është bërë pjesë (është faturuar) e Faturës Nr..., datë 29.10.2010 të cilës i korespondon situacioni i muajit Shkurt të vitit 2009. Pra edhe vetëm nga analiza e këtyre dokumentave arrihet në konkluzionin se faturat dhe situacionet e përmendura në këtë paragraf janë fiktive, sepse nëse punimet ishin marrë në dorëzim në muajin Shkurt të vitit 2009, nuk kishte pse në muajin Maj të vitit 2009 të lëshohej faturë paradhënie për këto punime. Kjo tregon se situacionet për këto punime janë krijuar (janë prodhuar) me përmbajtje të falsifikuar, shumë kohë më pas dhe personat që i kanë prodhuar këto situacione kanë bërë gabime llogjike duke dashur të realizojnë qëllimin e tyre. Pra është fare e qartë se Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk për qëllime të saj të kundraligjshme, ka kaluar paratë tek Shoqëria “E.....” shpk dhe në mënyrë fiktive ka prerë një faturë paradhënie për të justifikuar transaksionin. Më pas, ka prerë situacione të falsifikuara dhe ka lëshuar fatura fiktive.

Mbi bazën e vendimit gjyqësor të arbitrazhit Shoqëria “E....” shpk ka përfituar nga Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk miliona Euro, të cilat janë transferuar në llogaritë bankare të Shoqërisë “E.....” shpk nga muaji Tetor i vitit 2013 e në vazhdim.

Nga analiza e të dhënave të administruara në këtë procedim penal rezulton se qëllimi i “krijimit” të mosmarëveshjes fiktive dhe gjykimit fiktiv në arbitrazh, rezulton të jenë mosmarëveshjet reale që Shoqëria konçensionare ka me shoqëritë e tjera si psh: “D... B...” si dhe transferimi i parave të cilat dyshohet të vijnë nga veprimtari të paligjshme kriminale.

Paratë e përfituara në këtë mënyrë nga Shoqëria “E....” shpk, të cilat kanë si burim Vendimin e dt.20.08.2013, janë para të cilat kanë rrjedhur nga vepra penale e “Falsifikimit të dokumentave” e parashikuar nga neni 186 i K.Penal dhe përdorimit të këtyre dokumentave të falsifikuara në Gjykatën e “M.....”.

Nga organi i Prokurorisë konkludohet se paratë e transferuara në llogarinë e Shoqërisë “E.....” shpk nga Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k shpk, të pasqyruara në bilancin e kësaj shoqërie si të “ardhura gjyqësore”, në fakt janë para të cilat kjo shoqëri i ka përfituar nëpërmjet një skeme fiktive dhe me dokumenta të falsifikuara të ndërhuara nga përfaqësues të dy Shoqërive “K... G... E...” sh.p.k shpk dhe “E.....” shpk për qëllimet e tyre të paligjshme kriminale. Si rrjedhojë, këto para nuk janë para të një aktiviteti të ligjshëm tregtar, por minimalisht janë rrjedhojë e veprës penale të falsifikimit të dokumentave.

Më pas, këto para Shoqëria “E...” shpk i ka riinvestuar në Shoqëri të tjera si: “4...” shpk, “C... s...” shpk dhe “C.....” shpk, të cilat janë shoqëri po të grupit “B.....” SPA.

Nga sa u parashtrua e argumentua më sipër, Prokuroria konkludon se në dosjen penale Nr..... të vitit 2014 janë administruar të dhëna të mjaftueshme për t’i atribuar shtetasve nën hetim F. B., M. D. R., E. T. dhe L. C., elementët që tregojnë kryerjen e veprave penale: “Mospagimin e taksave dhe tatimeve”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 181, 186 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga të dhënat e administruara nga regjistrimi si persona juridikë të shoqërive italiane, të dhënat në QKR apo nga bankat e nivelit të dytë, aktualisht rezulton kjo përbërje e shoqërive:

- Shoqëria “K... G... E...” sh.p.k sh.p.k. zotërohet sot nga ortaku i vetëm Shoqëria italiane “H.....” Srl. me 100% të kuotave.

- Shoqëria italiane “H...” Srl. zotërohet nga ortaku i vetëm Shoqëria “B.....” spa (koncesionari për) me 100% të kuotave.

- Shoqëria “B.....” spa zotërohet nga ortakët:

1.F. B. – 20%

2.L. C. – 20%

3.C. B. – 20%

4.M. C. – 20%

5.S. G. – 10%

6.D. C. – 5%

7.D. C. – 5%

-Shoqëria “E...” shpk zotërohet nga ortakët: M. D. R. me 20% të kuotave dhe nga Shoqëria italiane “C.....” me 80% të kuotave. Kjo e fundit zotërohet në masën 99,5 % nga shtetasia italiane L. C. dhe në masën 0,5% nga shtetasia italiane S. G..

-Shoqëria “C... S...” shpk zotërohet nga ortakët: E. T. me 20% të kuotave dhe nga Shoqëria italiane “C....” srl me 80% të kuotave.

-Shoqëria “4...” shpk zotërohet nga ortakët: E. T. me 20% të kuotave dhe nga Shoqëria . “C.....” srl me 80% të kuotave.

- Shoqëria “F...” sh.p.k zotërohet nga ortakët: Shoqëria “4...” shpk me 70% të kuotave; M. D. R. me 15% të kuotave dhe E. T. me 15% të kuotave.

-Shoqëria “A.....” shpk zotërohet nga ortakët: Shoqëria “C.....” srl (e cila ka blerë së fundmi me dt.07.10.2014 kuotat e Shoqërisë “4...” shpk) me 40% të kuotave; Shoqëria “F...” shpk me 20% të kuotave dhe Shoqëria “I.....” shpk me 40% të kuotave.

- Shoqëria "I....." shpk zotërohet nga ortakët: C. B. me 40% të kuotave; F. B.. me 40% të kuotave dhe S. G. me 20% të kuotave.

Duke iu referuar të dhënave të përmendura më sipër rezulton se shtetasit nën hetim L. C., M. D. R.s dhe E. T., zotërojnë në Shoqërinë "A." shpk (nëpërmjet kuotave të tyre tek Shoqëria "C....." shpk prej 40% dhe Shoqëria "F....." shpk prej 20%) kuotat si më poshtë:

-L. C. – 51%

-M. D.R. – 3%

-E. T. – 5.8%.

Nga hetimet paraprake ka rezultuar se një pjesë e konsiderueshme e parave të përfituara nga Shoqëria "E....." shpk, ku bëjnë pjesë paratë në lidhje me punimet e përshkruara sa sipër për, paratë që duhet të ishin paguar në tatime si edhe ato të përfituara si të ardhura gjyqësore nëpërmjet procesit të arbitrazhit, kanë kaluar nga Shoqëria "E....." shpk tek Shoqëritë "C... s..." shpk, Shoqëria "4..." shpk dhe më pas, tek Shoqëria "A....." shpk. Nga organi i akuzës konkludohet se, nga të dhënat e deritanishme, rezulton se paratë që rrjedhin nga vepra penale e "Mospagimit të taksave dhe tatimeve" e parashikuar nga neni 181 i K.Penal, dhe paratë që janë produkt i veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" e parashikuar nga neni 186 i K.Penal, kanë kaluar kryesisht së fundmi tek Shoqëria "C....." shpk. Shoqëria "A....." shpk.

Nga hetimet paraprake të deritanishme, bazuar në aktin e ekspertimit kontabël të kryer nga Prokuroria, rezulton në konkluzion se paratë e fituara apo të mbajtura në mënyrë të kundraligjshme e që janë përdorur si mjet për kryerjen e veprave penale "Mospagimit të taksave dhe tatimeve", "Falsifikimi i dokumentave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara përkatësisht nga nenet 181, 186 dhe 287 i K.Penal, janë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

-Vlera e punimeve të shitura (faturuara), të pakryera, me situacione fiktive dhe të parregullta, për periudhën 2007-2013 që Shoqëria "E....." shpk i ka faturuar Shoqërisë "K... G... E..." sh.p.k shpk është në shumën **23,720,532 Euro**.

-Vlera e përfituar nga Shoqëria "E....." shpk në gjykimin në me Shoqërinë "K... G... E..." sh.p.k shpk është në shumën **15,281,331Euro**.

-Vlera e detyrimeve tatimore të Shoqëria "E....." shpk të papaguara është në shumën **770,423,159 lekë**.

Lidhur me sa u parashtrua më sipër, Prokuroria argumentoi se në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, që sendet dhe produktet e veprave penale që janë transferuar ose shndërruar tërësisht ose pjesërisht në pasuri të tjera, duhet t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe më pas konfiskimit. Në këto kushte, në bazë të dispozitave sa sipër dhe në fazën që

ndodhet hetimi paraprak, kërkoi lejimin e sekuestrimit të pasurive që shtetasit nën hetim L. C., M. D. R. dhe E. T. zotërojnë në raport me kuotat e tyre në Shoqërinë “E.....” sh.p.k, Shoqërinë “C... S...” shpk, Shoqërinë “4...” sh.p.k, Shoqërinë “F.....” sh.p.k dhe Shoqërinë “A.....” shpk, në vlerën (23,720,532 Euro+15,281,331Euro) =**39.001.863 euro** dhe **770,423,159 lekë**. Gjithashtu, Prokuroria kërkoi që për ekzekutimin e këtij vendimi dhe administrimin e pasurive që do të sekuestrohen, të ngarkohen administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

Lidhur me sa u kërkua nga Prokuroria, Gjykata vëren se kërkesa e paraqitur prej saj duhet pranuar si e bazuar në prova e në ligj. Në rastin konkret, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural penal për vendosjen e sekuestros preventive të sendeve, produktetev të veprës penale e të cdo lloji tjetër pasurie që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal.

Në nenin 208/1 të K.Pr.Penale parashikohet se:

“1.Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arësytuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.”

Në nenin 274 “Objekti i sekuestros prevendive” të K.Pr.Penale parashikohet se:

“1.Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsytuar.

2.Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe cdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3.Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”

Në nenin 36 “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale” të K.Penal parashikohet se:

“1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;

b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;

c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;

ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;

d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë veprë penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.”

Gjykata vëren se në rastin konkret, nga ana e Prokurorisë po hetohet dhe ka nisur procedimi penal Nr....., të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në të cilin parashikohet se:

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;
dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në pesë milionë lekë.

Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në tetë milionë lekë.

E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim dhe me gjobë nga tre milionë gjer në dhjetë milionë lekë.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”

Sekuestrimi i sendeve të kërkuara nga Prokuroria është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve, vërtetimin e fakteve që provojnë kryerjen e veprës penale, pengimin e rëndimit apo zgjatjes së pasojave që kanë ardhur nga vepra

penale që dyshohet se është kryer nga personat nën hetim, si edhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale apo të të njëjtit lloj.

Bazuar në sa më sipër dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata konkludon se përmbushen kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji procedural penal për sekuestron preventive të sendeve të përdorura si mjet i veprës penale dhe i produkteve të ardhura si rrjedhojë e përdorimit të tyre, dhe se kërkesa e Prokurorisë duhet pranuar si e bazuar në ligj e në prova.

PËR KËTO ARËSYE:

Gjykata duke u bazuar në nenet 208 dhe 274 të K.Pr.Penale dhe nenit 36 të K.Penal,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lejimin e sekuestrimit të sendeve të luajtshme (llogari bankare etj.) e të paluajtshme, që shtetasit nën hetim L. C., M. D. R. dhe E. T. zotërojnë në raport me kuotat e tyre në Shoqërinë “E.....” sh.p.k, Shoqërinë “C... S...” shpk, Shoqërinë “4...” sh.p.k, Shoqërinë “F.....” sh.p.k dhe Shoqërinë “A.....” shpk, deri në shumat **39.001.863** (tridhjetë e nëntë milionë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) **euro** dhe **770,423,159** (shtatëqind e shtatëdhjetë milionë e katërqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë**, që Shoqëria “E.....” shpk ka përfituar dhe transferuar tek Shoqëria “4...” shpk, Shoqëria “F.....” shpk dhe Shoqëria “A....” shpk, lidhur me procedimin penal me Nr....., të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.
3. Për ekzekutimin e këtij vendimi dhe administrimin e pasurive që do të sekuestrohen, ngarkohen administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve, nga të interesuarit që kanë ardhur në dijeni të këtij vendimi.
U shpall sot me dt. 05.06.2015, Tiranë.

SEKRETARE
ELIANA SHARRA

GJYQTARE
MANJOLA BEJLERI